

L I G J
Nr.8237, datë 1.9.1997

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7926, DATË 20.4.1995 "PËR TRANSFORMIMIN E
NDËRMARRJEVE SHTETËRORE NË SHOQËRI TREGTARE", NDRYSHUAR ME
DEKRETIN NR.1195, DATË 14.8.1995, LIGJIN NR.8099, DATË 28.3.1996, DEKRETIN
NR.1631, DATË 1.11.1996 DHE LIGJIN NR.8158, DATË 7.11.1996**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7926, datë 20.4.1995, në të gjitha dispozitat ku janë përdorur fjalët "Ministria e Privatizimeve", bëhet ndryshimi dhe zëvendësimi me fjalët "Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit".

Neni 2

Neni 4 i ligjit ndryshohet si vijon:

"Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit është përfaqësuese e pronarit për pronën shtetërore.

Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, përveç të drejtave që rrjedhin nga të qenët përfaqësues i pronarit shtetëror, kryen transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare dhe privatizimin e tyre, drejton punën për hartimin e akteve të themelimit të shoqërive që krijohen nga transformimi i ndërmarrjeve, nënshkruan kapitalin themeltar dhe autorizon regjistrimin e tyre.

Ministritë, departamentet, drejtoritë a institucionet e tjera që varen drejtpërdrejt nga Këshilli i Ministrave, si dhe organet përkatëse të pushtetit lokal, përgjigjen për administrimin e pronës shtetërore që kanë në varësi.

Prona shtetërore në shoqëritë me kapital të përbashkët administrohet nga organi që ka bërë nënshkrimin e pjesës shtetërore të kapitalit, ose, kur kjo nuk është kryer, administrohet nga dikasteri a organi i pushtetit lokal, nga i cili ka pasur varësinë në momentin e nënshkrimit të kontratës. Transferimi i së drejtës së ortakut shtetëror në këto shoqëri (si kapitali i pjesës shtetërore etj.) bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi, sipas kriterëve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave".

Neni 3

Neni 8 i ligjit ndryshohet si vijon:

"Organet drejtuese të shoqërive anonime janë:

- Këshilli mbikëqyrës
- Drejtoria

Këshilli mbikëqyrës përbëhet nga 3-9 anëtarë, të cilët nuk janë të punësuar në shoqëri.

Anëtarët e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë tregtare që janë në juridiksionin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, emërohen nga ministri i kësaj ministrie.

Në të gjitha shoqëritë e tjera anëtarët e këshillit mbikëqyrës emërohen nga ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, por 1/3 e anëtarëve të këshillit propozohen nga ministritë përkatëse, departamentet, drejtoritë a institucionet e tjera që varen drejtpërdrejt nga Këshilli i Ministrave, si dhe organet përkatëse të pushtetit lokal.

Drejtoria emërohet dhe shkarkohet nga këshilli mbikëqyrës, kur për të bien dakord jo më pak se 2/3 e tij.

Shpërblimi i veçantë për pjesëmarrje në këshillin mbikëqyrës dhe shpërblimet e jashtëzakonshme për shërbimet a detyrat që u besohen anëtarëve të këshillit, rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 109 i ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" nuk zbatohet për aq kohë sa shteti do të jetë aksionar i vetëm".

Neni 4

Dekreti nr.1195, datë 14.8.1995 "Për një ndryshim në ligjin nr.7926, datë 20.4.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", shfuqizohet.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1893, datë 5.9.1997 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani